



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 Qershor 2008 , nenit 15 dhe 16 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe nenit 9, 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, duke u bazuar në Shkresën e MAPL-së 020-199/4 të datës 06.07.2020 mbi Raportin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit , Shkresës përcjellëse të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit Nr.2842/20 të datës 22.06.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.07. 2020 pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratojë këtë:

VENDIM

PËR TRAJTIMIN E PARCELËS KADASTRALE P-71409044-01745-0 NË PROCESIN E SHQYRTIMIT PUBLIK DHE FINALIZIMIT TË DOKUMENTIT TE ARDHSHËM TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR- HARTA ZONALE E KOMUNËS SE LIPJANIT

I. Anullohet Vendimi 15Nr.463-12519 i datës 28.02.2020 për parcelën kadastrale P-71409044-01745-0 ,konform Shkresës përcjellëse të MAPL-së 020-199/4 të datës 06.07.2020 mbi Raportin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit dhe Shkresës përcjellëse të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit Nr.2842/20 të datës 22.06.2020.

II. Obligohet, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi konform dispozitave të Ligjit për Planifikimin Hapësinor dhe rekomandimeve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit të zhvillojë procedurat ligjore për finalizimin e dokumentit të planifikimit -Harta Zonale të Komunës ndërsa parcela kadastrale P-71409044-01745-0 në Zonën Kadastrale Lipjan në vendin e quajtur "Varosh" të trajtohet dhe përfshihet si pjesë e zonës gjatë procesit të shqyrtimit publik të Hartës Zonale të Komunës dhe miratimit të

dokumenteve të ardhshme të planifikimit hapësinor, konform kushteve zhvillimore të percaktuara në Hartën Zonale të Komunës së Lipjanit

III. Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Nr.15- 020-32603

Lipjan, më 30. 07. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

